



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 543, datë 01.10.2024

**PËR
SHPALLJEN E POZICIONEVE TË LIRA
PËR GJYQTARËT E EMËRUAR MË DATË 31.07.2024, TË DIPLOMUAR NË
PËRFUNDIM TË PROGRAMIT TREVJEÇAR TË FORMIMIT FILLESTAR 2021-
2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 31.07.2024 dhe pozicionet e lira në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2023-2024 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 31.07.2024.
2. Pozicionet e lira janë si më poshtë:
 - i) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 - ii) **tre** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
 - iii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 - iv) **pesë** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 - v) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
 - vi) **katër** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

- vii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 - viii) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
 - ix) **dy** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
 - x) **katër** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
 - xi) **tre** pozicione në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 - xii) **një** pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.
3. Të emëruarit gjyqtarë në përfundim të programit të formimit fillestar 2021-2024 kanë të drejtë të për zgjedhin, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.
4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
5. Afati i aplikimit është deri më datë 02.10.2024, ora 13.³⁰. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.
6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:
- i) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.
 - ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), i emëruar me Vendimin nr. ____, datë 31.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 8, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale, sipas nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastin e caktimit në një prej gjykatave të shkallës së parë të shpallura me Vendimin nr. 543, datë 01.10.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lëshuar më ____.10.2024

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)